



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.106/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova - kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, të paraqitur kundër subjektit politik Srpska Demokratija - SD, me seli në Mitrovicë e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 08.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PA BAZUAR ankesa e subjektit politik, Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, ZL.Anr.106/2025, e datës 05.10.2025, paraqitur kundër subjektit politik Srpska Demokratija - SD, me seli në Mitrovicë e Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 05.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër ZL.Anr.106/2025, nga subjekti politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, me seli në Graçanicë, me te cilën pretendon Duke ndjekur rrjetet sociale, aktivistët e SPO vunë re se në profilin në Instagram të Srpska Demokratija, Vladimir Radosavljević (i padituri), kandidat për kryetar komune në Leposaviq, transmetoi një video/bisedë me zëvendëskryetarin e komunës së Leposaviqit, Marina Bogojević, në lidhje me dhënien e banesave për kategoritë sociale që i përkasin komunës së Leposaviqit. Në video, dy herë u përmend kryetari i partisë Za Slobodu Pravdu i Opstanak, Nenad Rasić, ku ai shpifet dhe çvlerësohet me pohime të pavërteta në lidhje me dhënien e banesave në komunën e Leposaviqit. Këto pohime janë të rreme dhe jo të sakta dhe publikimi është bërë pa kontrolluar vërtetësinë, pa u informuar se pohimet janë të sakta, gjë që ka shkelur ligjin 02/L-65, neni 5, pika 5.1, 5.2 dhe 5.3, përgjegjësia për shpifje dhe fyerje. Ky publikim ka shkaktuar dëm në formën e dëmtimit të reputacionit, nderit, dinjitetit të paditësit, mundësinë e humbjes së besimit të publikut, si dhe dëm profesional. Kërkojmë që PZAP të miratojë ankesën si të bazuar.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një video CD.

Në përgjigje në ankesë, subjekti politik Srpska Demokratija - SD, ka deklaruar se ankimi i referohet një video material nga data 31 dhjetor 2024, i cili është filmuar dhe publikuar para

10 muajsh e 8 ditësh dhe shumë përpara shpalljes së këtyre zgjedhjeve vendore. Pra, videoja e diskutuar nuk ka asnjë lidhje me procesin aktual zgjedhor dhe as me fushatën e vitit 2025. Duke qenë se videoja e diskutuar nuk është pjesë e fushatës për këto zgjedhje, PZAP nuk ka kompetencë të vendosë për këtë ankim, dhe për këtë arsye ajo duhet të refuzohet si e pabazuar. Po ashtu, në kohën e filmimit të videos së diskutuar (31.12.2024) Marina Bogojević ishte anëtare e partisë SPO, kryetare e së cilës është Nenad Rašić. Tema e bisedës ishte dhënia e banesave dhe parregullsitë në lidhje me qendrat kolektive dhe familjet e zhvendosura – një problem që deri më sot nuk është zgjidhur dhe për të cilin ekzistojnë shumë dëshmi të përdorshme publike. Në përmbajtjen e diskutueshme nuk ka shpifje, fyerje apo përcëmime, por bëhet fjalë për koment politik me interes publik. Çështja e dhënies së banesave dhe keqpërdorimeve në lidhje me qendrat kolektive është e dokumentuar në burime publike dhe nuk përfaqëson trillim apo fushatë kundër Nenad Rašićit. Bazuar në të lartëcekurat, propozojmë që PZAP të refuzojë ankesën si të pabazuar dhe jashtë kompetencës.

Si prove në përgjigje në ankesë ka bashkangjitur linqet:

Mbyllja e rreme e qendrave kolektive <https://www.facebook.com/reel/30706715975582426>

Grabitja e banesave nga të zhvendosurit <https://www.facebook.com/reel/1645147876133770>

Burime gazetareske - <https://alternativna.com/cetiri-raseljene-porodice-u-strahu-da-ce-biti-izbacene-iz-stanova-u-leposavicu/> dhe <https://kossev.info/ko-gradi-ko-dodeljuje-a-ko-menja-brave-na-stanovima-uleposavicu/>

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik Srpska Demokratija - SD, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk ka mundur të argumentohet me asnjë provë, pasi që pala ankuese nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, dhe në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin. Bazuar në këtë subjekti politik Za Slobodu, Pravdu i Opstanak, përmes videos të bashkangjitur dhe pretendimeve ankimore nuk ka përcaktuar kohën e kryerjes së shkeljes së supozuar, si rrjedhojë nuk mund të verifikohet përmbushja e afatit ligjor për paraqitjen e ankesës. Andaj, në mungesë të provave paneli arrin në përfundim se pretendimet e parashtruesit nuk gjejnë mbështetje faktike apo juridike dhe rrjedhimisht, ankesa refuzohet si e pabazuar.

Duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi nga parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë se përbëjnë shkelje të kodit të mirësjelljes.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nën 117 par. 3, lidhur me nën 118 pa. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa
ZL.Anr.106/2025 datë 08.10.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husej Rugova

The stamp is a blue circular seal. The outer ring contains the text "Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa" at the top and "Prishtinë / Pristina" at the bottom. The center of the seal features the acronym "PZAP" in large, bold letters, with the year "1999" below it. A blue ink signature is written across the center of the seal, overlapping the text.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nënit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.